

The background image shows the interior of a mosque, featuring a series of repeating arches supported by columns. The floor is covered in a black and white checkered tile pattern. The ceiling is dark with intricate circular patterns. The lighting is warm and focused on the arches, creating a sense of depth and architectural grandeur.

# NJË PËRGJIGJE RRETH CAKTIMIT

ESSUNNEH.COM

Shejhul-Islam  
**IBËN TEJMIJE**

## Bismil-lâhir-Rahmânir-Rahim

Shejhul-Islam Tekijjuddin Ebul-Abbas (**Ibën Tejmije**)  
është pyetur në lidhje me hadithin e transmetuar:

{إِنَّ اللَّهَ قَبَضَ قَبْضَتَيْنِ فَقَالَ: هَذِهِ لِلْجَنَّةِ وَلَا أُبَالِي وَهَذِهِ لِلنَّارِ وَلَا أُبَالِي}

*“All-llahu ka kapur dy Grushte (nga pasardhësit e Ademit) dhe ka thënë: **“Këta (do t’i çoj) në Xhenet dhe nuk merakosem, kurse këta në Zjarr dhe nuk merakosem!”***

A është ky hadith i saktë? A i ka kapur All-llahu Vetë, apo e ka urdhëruar ndonjërin prej engjëjve? Ndërsa hadithi tjetër thotë:

{إِنَّ اللَّهَ لَمَّا خَلَقَ آدَمَ أَرَاهُ ذُرِّيَّتَهُ عَنِ الْيَمِينِ وَالشَّمَالِ ثُمَّ قَالَ هُوَ لَاءِ إِلَى النَّارِ وَلَا أُبَالِي وَهُوَ لَاءِ إِلَى الْجَنَّةِ وَلَا أُبَالِي}

*“Kur All-llahu e ka krijuar Ademin, ia ka paraqitur pasardhësit në të djathtë dhe në të majtë, pastaj ka thënë: **“Këta (do t’i çoj) në Zjarr dhe nuk merakosem, kurse këta në Xhenet dhe nuk merakosem!”*** - ky a është në “Sahih”?

**Ibën Tejmije (رضي الله عنه) është përgjigjur:**

Po. Transmetimet e Profetit (ﷺ) me këtë kuptim janë të njohura dhe janë përcjellë në disa versione, si për shembull transmetimi që gjendet në “Muwetta” të Malikut, në “Sunenin” e Ebu Davudit, atë të Nesaiut dhe në libra të tjerë, të cilin e përcjellë Muslim ibën Jesâr – sipas njërit variant: nga Nuajm ibën Rabi’a – e në të thuhet se:

“Umer ibnul-Hattâbi është pyetur për këtë ajet:

وَإِذْ أَخَذَ رَبُّكَ مِنْ بَنِي آدَمَ مِنْ ظُهُورِهِمْ ذُرِّيَّتَهُمْ وَأَشْهَدَهُمْ عَلَىٰ أَنفُسِهِمْ أَلَسْتُ بِرَبِّكُمْ ۖ قَالُوا بَلَىٰ ۗ شَهِدْنَا ۗ أَن تَقُولُوا يَوْمَ الْقِيَامَةِ إِنَّا كُنَّا عَنْ هَذَا غَافِلِينَ (172)

**“Kur Zoti yt nxori nga kurrizi i bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri të dëshmojnë ndaj vetëve të tyre, u tha: “A nuk jam Unë Zoti juaj?” Ata u përgjigjën: “Po, dëshmojmë se Ti je.” Kështu bëri Ai, në mënyrë që ju (o njerëz) të mos thoni në Ditën e Kiametit: “Këtë nuk e kishim ditur.” [El-A’râf, 172]**

Umeri është përgjigjur: “I Dërguari (ﷺ) ka thënë...” – në një variant thotë: “E kam dëgjuar njëherë kur e pyetën të Dërguarin e All-llahut (ﷺ) për këtë, ndërsa ai u përgjigj:

إِنَّ اللَّهَ خَلَقَ آدَمَ ثُمَّ مَسَحَ ظَهْرَهُ بِيَمِينِهِ فَاسْتَخْرَجَ مِنْهُ ذُرِّيَّةً فَقَالَ خَلَقْتُ هَؤُلَاءِ لِلْجَنَّةِ وَيَعْمَلُ أَهْلُ الْجَنَّةِ يَعْمَلُونَ ثُمَّ مَسَحَ ظَهْرَهُ فَاسْتَخْرَجَ مِنْهُ ذُرِّيَّةً فَقَالَ: خَلَقْتُ هَؤُلَاءِ لِلنَّارِ وَيَعْمَلُ أَهْلُ النَّارِ يَعْمَلُونَ

**“All-llahu e ka krijuar Ademin pastaj e ka fshirë shpinën e tij me Dorën e djathtë, ka nxjerr prej tij pasardhës dhe ka thënë: “Këta i kam krijuar për Xhenet dhe do t’i bëjnë veprat e banorëve të**

**Xhenetit (në dynja).” Pastaj ia ka fshirë (prapë) shpinën, ka nxjerr prej tij pasardhës dhe ka thënë: “Këta i kam krijuar për Zjarr dhe do t’i bëjnë veprat e banorëve të Zjarrit.”**

Atëherë njëri e pyeti: “O i Dërguar i All-llahut, po për çfarë punojmë atëherë?” Ai është përgjigjur:

إِنَّ اللَّهَ إِذَا خَلَقَ الرَّجُلَ لِلْجَنَّةِ اسْتَعْمَلَهُ بِعَمَلِ أَهْلِ الْجَنَّةِ حَتَّى يَمُوتَ عَلَى عَمَلٍ مِنْ أَعْمَالِ أَهْلِ الْجَنَّةِ فَيُدْخِلُهُ بِهِ الْجَنَّةَ. وَإِذَا خَلَقَ الرَّجُلَ لِلنَّارِ اسْتَعْمَلَهُ بِعَمَلِ أَهْلِ النَّارِ حَتَّى يَمُوتَ عَلَى عَمَلٍ مِنْ أَعْمَالِ أَهْلِ النَّارِ فَيُدْخِلُهُ بِهِ النَّارَ

**“Njeriun që All-llahu e ka krijuar për Xhenet, e shtie (ia mundëson, i jep sukses) t’i veprojë punët e xhenetlinjve, deri sa ai të vdesë duke vepruar ndonjëherë prej punëve të xhenetlinjve, dhe sepse saj futet në Xhenet. Ndërsa njeriun që e ka krijuar për Zjarr, e shtie t’i veprojë punët e banorëve të Zjarrit, deri sa të vdesë duke vepruar ndonjëherë prej punëve të banorëve të Zjarrit dhe sepse saj futet në Zjarr.”[1]**

Në transmetimin e el-Hakem ibën Sufjan, nga Thabiti, nga Enes ibën Maliku se ai ka thënë: “I Dërguari i All-llahut (ﷺ) ka thënë:

إِنَّ اللَّهَ قَبِضَ قَبْضَةً فَقَالَ: إِلَى الْجَنَّةِ بِرَحْمَتِي وَقَبِضَ قَبْضَةً فَقَالَ: إِلَى النَّارِ وَلَا أُبَالِي  
**“All-llahu ka kapur një Grusht (prej pasardhësve të Ademit) dhe ka thënë: “(Këta do t’i çoj) në Xhenet, me mëshirën Time” dhe ka kapur një Grusht tjetër dhe ka thënë: “Në Zjarr, dhe nuk merakosem!”[2]**

[1] Shejh Albani: “Sahih, përveç fshirjes së shpinës.” - “Sahih we da’if Sunen Ebi Dawud”,4703.

[2] Shejh Albani: “Sahih.” - “Xhâmi’ es-Sagir”, 1784 dhe “Es-Sahihah”, 47.

Në këtë hadith dhe në hadithet e ngjashme me të ka dy tema.

[Tema e parë] **Kaderi i paracaktuar.**

Kjo nënkupton se All-llahu i Lartësuar e ka ditur kush janë banorët e Xhenetit e kush banorët e Zjarrit para se ata t'i veprojnë veprat. Kjo është një e vërtetë, që e kemi për detyrë ta besojmë. Madje imamët si Maliku, Shafiu dhe Ahmedi janë shprehur qartë se kush e mohon këtë, bën kufër.

Bile, është obligim të besojmë se **All-llahu e ka ditur çdo gjë që do të ekzistojë**, absolutisht çdo gjë, para se të ekzistojë. Gjithashtu, është obligim t'i besojmë lajmit të Tij: se **Ai i ka shkruar ato dhe i ka treguar para se të bëhen**. Siç transmetohet te “Sahihu” i Muslimit, nga Abdull-llah ibën Amër, se Profeti (ﷺ) ka thënë:

إِنَّ اللَّهَ قَدَّرَ مَقَادِيرَ الْخَلَائِقِ قَبْلَ أَنْ يَخْلُقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ بِخَمْسِينَ أَلْفَ سَنَةٍ  
وَكَانَ عَرْشُهُ عَلَى الْمَاءِ

*“All-llahu i ka paracaktuar kaderet (përmasat, veprat dhe gjithçka tjetër) e krijesave pesëdhjetëmijë vjet para se t'i krijojë qiejt dhe tokën, teksa Froni i Tij ndodhej mbi ujë.”*

Në Sahihun e Buhariut dhe libra të tjerë transmetohet nga Imrân ibën Husajn-i se Profeti (ﷺ) ka thënë:

كَانَ اللَّهُ وَلَا شَيْءَ غَيْرُهُ وَكَانَ عَرْشُهُ عَلَى الْمَاءِ وَكَتَبَ فِي الذِّكْرِ كُلِّ شَيْءٍ وَخَلَقَ  
السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ

“Ka qenë All-llahu (pa fillim) dhe s’ka ekzistuar asgjë tjetër pos Tij. (Pastaj) Froni i Tij ndodhej mbi ujë. Ai ka shkruar te Dhikri (Leuhi Mahfûdh) çdo gjë dhe i ka krijuar qiejt dhe Tokën.”

Në një transmetim:

ثُمَّ خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ

“...pastaj i ka krijuar qiejt dhe Tokën.”

Në “Musned” është transmetuar nga Irbâd ibën Sârije se Profeti (ﷺ) ka thënë:

إِنِّي عِنْدَ اللَّهِ مَكْتُوبٌ بِخَاتِمِ النَّبِيِّينَ وَإِنَّ آدَمَ لَمُنْجَدِلٌ فِي طِينَتِهِ وَسَأَنْبِتُكُمْ بِأَوَّلِ ذَلِكَ دَعْوَةَ أَبِي إِبْرَاهِيمَ وَبُشْرَى عِيسَى وَرُؤْيَا أُمِّي رَأَتْ حِينَ وَلَدْتَنِي أَنَّهُ خَرَجَ مِنْهَا نُورٌ أَضَاءَتْ لَهُ قُصُورُ الشَّامِ

“Unë tek All-llahu jam i shkruar si “Vula e Profetëve” derisa Ademi ka qenë i hedhur në tokë, gjatë krijimit të tij. Unë do t’ju njoftoj kur ka filluar kjo (lajmërimi për ardhjen e profecisë sime): kur babai im Ibrahim (alejhis-selâm) është lutur (kur e ka ndërtuar Qabenë, që All-llahu të dërgojë një të Dërguar në Meke sh.p.), kur Isai ka dhënë lajmin e gëzuar (për ardhjen time sh.p.) dhe ëndrra që e ka parë nëna ime, pasi më ka lindur; ajo ka ëndërruar sikur prej saj ka dalë një dritë, nga e cila kanë ndriçuar pallatet e Shamit.” [1]

Ndërsa te hadithi i transmetuar nga Mejsera elFexhër:

“Thashë: O i Dërguar i All-llahut! Kur je shkruar si Profet?” – në një tjetër variant: “Prej kur je (caktuar) profet?” – Profeti (ﷺ) ka thënë:

[1] Shejh Albani: “Sahih ligajrih” – Es-Sahih, 1546.

“Atëherë kur Ademi ishte mes shpirtit dhe trupit (para lidhjes së shpirtit me trupin sh.p.).”

Në dy Sahihët është transmetuar nga Abdull-llah ibën Mes’udi (radijAll-llahu anhu) se ka thënë:

“Na ka treguar i Dërguari i All-llahut (ﷺ) – i cili është i singerti dhe besniku – se:

“Krijimi i çdonjërit prej jush bashkohet në barkun e nënës së tij (duke qëndruar) dyzet ditë si një pikë, pastaj shndërrohet në droçkë gjaku për po aq (ditë), pastaj shndërrohet në copëz mishi për po aq. Pastaj i dërgohet engjëlli, i cili urdhërohet me katër fjalë (caktime); i thuhet: “Shkruaja riskun, veprat, exhelin dhe në do të jetë i mjerë ose i lumtur (në botën e amshueshme). Pastaj i fryhet shpirti.” Ka thënë: “Pasha Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti im!” – ose ka thënë: “Pasha Atë, përveç të Cilit askush nuk meriton të adhurohet! – Prej jush ka të atillë që bën vepra të banorëve të Xhenetit, aq sa mes tij dhe Xhenetit të mos mbetet më shumë se një krah, por ja që e mund e shkruara, fillon të veprojë vepra të banorëve të Zjarrit dhe, rrjedhimisht, hyn në të.”

Në dy Sahihët është transmetuar se Alij ibën Ebi Tâlibi (radijAll-llahu anhu) ka thënë:

“Ishim me të Dërguarin e All-llahut (ﷺ) në (varrezat e) Bekî’ el-Garkad në një xhenaze dhe ai tha:

مَا مِنْكُمْ أَحَدٌ إِلَّا قَدْ كُتِبَ مَقْعَدُهُ مِنَ النَّارِ وَمَقْعَدُهُ مِنَ الْجَنَّةِ

*“Nuk ka asnjë njeri, të cilit nuk i është shkruar vendqëndrimi në Zjarr dhe vendqëndrimi në Xhenet!”*

Ata thanë: “O i Dërguar i All-llahut! A të mbështetemi tek e shkruara (kaderi) dhe t’i lëmë veprat?” Ai tha:

اعْمَلُوا فِكُلِّ مُيَسَّرٍ لِمَا خُلِقَ لَهُ أَمَّا مَنْ كَانَ مِنْ أَهْلِ السَّعَادَةِ فَسَيُسَّرُ لِعَمَلِ أَهْلِ السَّعَادَةِ وَأَمَّا مَنْ كَانَ مِنْ أَهْلِ الشَّقَاوَةِ فَسَيُسَّرُ لِعَمَلِ أَهْلِ الشَّقَاوَةِ

*“(Jo!) Veproni, sepse secilit i është lehtësuar rruga drejt asaj për të cilën është krijuar! Atij që është prej njerëzve të lumturisë (xhenetlinjve), do t’i lehtësohet t’i bëjë veprat e njerëzve të lumturisë, kurse atij që është prej njerëzve të mjerimit (xhehenemlinjve), do t’i lehtësohet t’i bëjë punët e njerëzve të mjerimit.”*

Pastaj Profeti (ﷺ) i ka lexuar Fjalët e All-llahut të Lartësuar:

فَأَمَّا مَنْ أَعْطَى وَاتَّقَى \* وَصَدَّقَ بِالْحُسْنَى \* فَسَنُيَسِّرُهُ لِلْيُسْرَى \* وَأَمَّا مَنْ بَخِلَ وَاسْتَغْنَى \* وَكَذَّبَ بِالْحُسْنَى \* فَسَنُيَسِّرُهُ لِلْعُسْرَى

**“5. Sa për atë që jep (për hir të All-llahut), ruhet (nga zemërimi i Tij) 6. dhe dëshmon për vërtetësinë e më të Bukurës (Xhenetit), 7. Ne do t’ia lehtësojmë atij rrugën drejt së mirës. 8. Kurse atij që është koprrac, ndihet i vetëmjaftueshëm, 9. dhe e quan gënjeshtër më të Bukurën, 10. Ne do t’ia lehtësojmë rrugën drejt së keqes”** [El-Lejl]

Në Sahih [të Buhariut dhe Muslimit] gjithashtu, transmetohet se i është thënë:



“O i Dërguar i All-llahut, a dihen kush janë banorët e Xhenetit e kush të Zjarrit?” Ai ka thënë: « **نعم** »

“*Po.*” Atëherë është pyetur: “Atëherë përse punojmë?”

Ai ka thënë:

« **اعْمَلُوا فَكُلُّ مَيْسَرٌ لِمَا خُلِقَ لَهُ** »

“*Veproni, sepse secilit i është lehtësuar rruga drejt asaj për të cilën është krijuar!*”

Pra, Profeti (ﷺ) ka sqaruar se All-llahu e ka ditur kush janë banorët e Xhenetit e kush banorët e Zjarrit dhe se Ai e ka shkruar këtë gjë. Por njëkohësisht ua ka ndaluar t’i mbështeten shkrimit e t’i lënë veprat, siç bëjnë të pafetë. Ka thënë se secilit i është lehtësuar rruga drejt asaj për të cilën është krijuar; se njerëzve të lumturisë (xhenetit) u është lehtësuar t’i kryejnë veprat e njerëzve të lumturisë dhe njerëzve të mjerimit u është lehtësuar t’i bëjnë veprat e njerëzve të mjerimit – dhe ky sqarim është prej më të bukurave të mundshme!

[Tema e dytë]

All-llahu (subhâneHu ue te’âlâ) i di gjërat ashtu siç janë në realitet, mirëpo Ai, **për të gjitha gjërat ka bërë paraprakisht shkaqe**, nga të cilat lindin ato gjëra. Pra, Ai e di që ato gjëra do të lindin si pasojë e atyre shkaqeve, siç e di, për shembull, që një personi do t’i lind fëmijë, mbasi ai do të kryejë marrëdhënie me një grua dhe do ta lërë shtatzënë.

Tani ky person, nëse thotë: “Pasi All-llahu e di se mua do të më lind fëmijë, atëherë s’kam nevojë të kryejë marrëdhënie!” – do të ishte budalla. Sepse All-llahu e ka ditur se kjo do t’i ndodhë sepse marrëdhëniet, që i ka paracaktuar.

Gjithashtu, kur All-llahu e di që filanit do t’i mbijnë të mbjellat, si pasojë e ujitjes me ujë dhe mbjelljes së farës, nëse ai thotë: “Pasi All-llahu e di që do të mbijnë, atëherë nuk ka nevojë për mbjellje!” – do të ishte injorant i humbur. Sepse All-llahu e ka ditur se do të mbijnë si pasojë e këtyre sebepeve.

Njësoj edhe kur All-llahu e di se filani do të ngopet përmes ngrënies, filani do ta shuajë etjen përmes pirjes, filani do të vdesë përmes vrasjes... Patjetër do të ketë sebepe, si pasojë e të cilave All-llahu e di se do të lindin këto çështje.

E, kështu është edhe kur All-llahu e di se filani do të jetë fatlumtur në Ahiret dhe tjetri fatmjerë në Ahiret. Themi: kjo është kështu sepse ky (fatzi) do t’i bëjë veprat e fatzinjve, kështu që All-llahu e ka ditur se ky do të përfundojë në mjerim si pasojë e këtyre veprave. E nëse dikush thotë: “Filani do të jetë xhehenemli, edhe nëse nuk bën gjë!” – do të ishte fjalë e kotë, sepse All-llahu nuk e fut askënd në Zjarr, përveçse për fajin e tij, siç ka thënë i Lartësuari:

لَأْمَلَانَ جَهَنَّمَ مِنْكَ وَمِمَّنْ تَبِعَكَ مِنْهُمْ أَجْمَعِينَ

**“Vërtet do ta mbush Xhehenemin me ty dhe me të gjithë ata që të pasojnë ty!” [Sâd, 85]**

Pra, është betuar se do ta mbushë Zjarrin me Iblisin dhe me ndjekësit e tij, e kushdo që e ndjekë Iblisin ka bërë gjynah ndaj All-llahut të Lartësuar.

All-llahu nuk e ndëshkon robin për një gjynah, që Ai e di se do ta veprojë, deri sa ta veprojë. Për këtë arsye, kur është pyetur Profeti (ﷺ) për fëmijët e idhujtarëve ka thënë:

اللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا كَانُوا عَامِلِينَ

**“All-llahu e di më së miri se çfarë do të vepronin ata!”**

- domethënë, All-llahu e di se çfarë vepra do të bënin sikur ta arrinin pubertetin. Në disa transmetime përmendet se Ditën e Kiametit, atyre do t’u dërgohet një i dërguar dhe kush i bindet do të hyjë në Xhenet e kush nuk i bindet do të hyjë në Zjarr. Kështu do të shfaqet ajo që e ka ditur All-llahu (paraprakisht), qoftë bindje apo mosbindje.

Kështu është edhe puna e Xhenetit. All-llahu e ka krijuar atë për njerëzit që i besojnë dhe i binden Atij. Dhe atyre njerëzve, që All-llahu e ka paracaktuar se do të jenë prej xhenetlinjve, ua lehtëson rrugën drejt imanit dhe bindjes.

E nëse dikush thotë: “Nëse All-llahu e di që unë jam prej xhenetlinjve, unë do të hyjë se do të hyjë në

Xhenet, qofsha musliman, qofsha qafir!” – atëherë është shpifës ndaj All-llahut. Sepse All-llahu e di që ai do të hyjë në Xhenet për shkak të imanit.

Nëse ky njeri nuk ka iman, atëherë nuk është personi për të cilin All-llahu e di se do të hyjë në Xhenet. Bile, për atë që nuk është besimtar, po qafir, All-llahu e di se do të jetë prej banorëve të Zjarrit, e jo prej xhenetlinjve.

Prandaj All-llahu i ka urdhëruar njerëzit që ata t'i luten Atij, t'i kërkojnë ndihmë e të bëjnë sebepe të tjera.

E kush thotë: “Unë nuk lutem dhe nuk kërkoj gjë, sepse mbështetem në kader!” – do të jetë i padrejtë, gjithashtu, sepse All-llahu e ka bërë duanë dhe lutjen prej shkaqeve, përmes të cilave arrihet falja, mëshira, udhëzimi, ndihma dhe risku i Tij.

Nëse e ka paracaktuar se filan njeriu do ta arrijë një gjë të mirë për shkak të lutjes, nuk do ta arrinte atë pa lutje.

Çdo gjendje dhe çdo përfundim të robërve, që All-llahu e ka paracaktuar dhe ditur, e ka paracaktuar vetëm me sebepe, që t'i udhëheqë kaderet drejt caktut kohor (kur do të ndodhin).

Kështu që nuk ka, as në dynja, as në Ahiret, diçka pa shkak. All-llahu është Krijuesi i shkaqeve dhe i pasojave.

## Prandaj disa dijetarë kanë thënë:

- T'i japësh vëmendjen shkaqeve (*të mbështetësh në sebepe, me bindje sikur ato veprojnë të pavarura nga caktimi dhe vullneti i All-llahut, sh.p.*) është një shirk që e cenon Teuhidin;
- mohimi i shkaqeve nga të qenit shkaqe, tregon për mangësinë e logjikës;
- shmangia tërësisht nga bërja e sebepeve, konsiderohet fyerje për ligjin e Zotit.

Por thjesht ekzistimi i sebepeve nuk e sjell detyrimisht pasojën. Nëse zbret shiu, pasi të mbillet fara, kjo nuk mjafton që të fitohet bima, porse patjetër duhet një erë me të cilën do të zhvillohet, me lejen e All-llahut, dhe patjetër duhet të shmangen gjërat që nuk e lejojnë paraqitjen e saj.

Pra, patjetër të plotësohen kushtet dhe të shmangen pengesat. Dhe të gjitha këto realizohen me vendimin dhe paracaktimin e All-llahut.

Njësoj edhe fëmija. Ai nuk lind vetëm me derdhjen e spermës në organ. Bile sa shumë ka atillë që derdhen por nuk u lind fëmija. Që të lindë duhet patjetër që All-llahu të ketë dashur ta krijojë; atëherë gruaja mbet shtatzënë, e zhvillon në barkun e saj dhe realizohen të gjitha kushtet përmes të cilave plotësohet krijimi i tij dhe largohen pengesat.

**E, kështu është edhe puna e Ahiretit.** Njeriu nuk mund ta arrijë lumturinë e amshueshme vetëm me punën e tij, por veprat e tij janë veç sebeb. Prandaj Profeti (ﷺ) ka thënë:

إِنَّهُ لَنْ يَدْخُلَ أَحَدُكُمْ الْجَنَّةَ بِعَمَلِهِ

*“Me të vërtetë, askush nuk ka për të hyrë në Xhenet me punën e tij!”*

Kanë thënë: “As ti, o i Dërguar i All-llahut?” Ka thënë:

وَلَا أَنَا إِلَّا أَنْ يَتَغَمَّدَنِي اللَّهُ بِرَحْمَةٍ مِنْهُ وَفَضْلٍ

*“As unë. Do të hyj vetëm nëse All-llahu më mbështjell me mëshirën dhe mirësinë e Tij.”*

Kurse në Kuran thuhet:

ادْخُلُوا الْجَنَّةَ بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ

**“Me veprat që keni kryer, hyni në Xhenet!”** [En-Nahl, 32]

Parafjala “me” në këtë ajet (arab. **الباء**) është ajo që përdoret për të treguar shkakun. Domethënë: “Për shkak të veprave tuaja, hyni...”.

Kurse “me”-ja që e ka mohuar Profeti (ﷺ) në hadithin (paraprak) është “me”-ja e kompensimit, sikur kur thuhet: “E bleva këtë me kaq (para).”

Pra, kuptimi i hadithit është që veprat e mira nuk janë si kompensim dhe çmim i mjaftueshëm për hyrjen në Xhenet, por duhet patjetër falja, mirësia dhe mëshira e Tij.

Me faljen e Tij i fshin gjynahet, me mëshirën e Tij sjell të mira dhe me mirësinë e Tij i shton begatitë.

## Në këtë pikë kanë devijuar dy grupe të njerëzve:

- Një grup kanë besuar në kader, por kanë menduar se kjo mjafton në arritjen e qëllimit dhe kanë hequr dorë nga kryerja e sebepeve sheriatike dhe veprave të mira. Këta njerëz, kjo bindje i çon në fund t'i mohojnë Librat, të dërguarit dhe fenë e All-llahut.
- Grupi tjetër kanë zënë t'ia kërkojnë All-llahut shpërblimin, siç ia kërkon punëtori punëdhënësit, duke u mbështetur në mundësinë, fuqinë dhe punën e tyre, dhe ashtu siç e kërkojnë skllëverit. Këta janë injorantë të humbur.

All-llahu nuk e ka urdhëruar robin me ato urdhra që e ka urdhëruar se ka ndonjë nevojë prej tij dhe as nuk e ka ndaluar nga ato që e ka ndaluar se do t'i kursejë ato (nga koprracia). Përkundrazi, i ka urdhëruar me gjëra që janë në interes të tyre dhe i ka ndaluar nga gjërat që janë në dëm të tyre. All-llahu i Lartësuar është ashtu siç ka thënë (për Vetën e Tij):

يَا عِبَادِي إِنَّكُمْ لَنْ تَبْلُغُوا ضُرِّي فَتَضُرُّوَنِي وَلَنْ تَبْلُغُوا نَفْعِي فَتَنْفَعُونِي

***“O robërit e Mi! Ju nuk mund të arrini të Më sillni dëm, që Unë të dëmtohesha nga ju dhe as nuk mund të arrini të Më sillni dobi, që Unë të përfitoja nga ju!”***

Mbreti kur e urdhëron popullin e vet diçka, i urdhëron sepse ka nevojë për ta, ndërsa ata e kryejnë urdhrin

---

[1] Në Musned etj, Shejh Albani: "Sahih" - es-Sahih, nr. 2602.

me fuqinë e tyre, të cilën ai nuk ua ka krijuar atyre, prandaj ata e kërkojnë hakun e asaj pune. Kurse All-llahu i Lartësuar është i Pasuri që s'ka nevojë për askënd.

Nëse ata bëjnë mirësi, e bëjnë për veten e tyre dhe nëse bëjnë keq, ia bëjnë po vetes. E mira që bëjnë është në dobi të tyre, kurse e keqja që e punojnë është në dëm të tyre;

مَنْ عَمِلَ صَالِحًا فَلِنَفْسِهِ وَمَنْ أَسَاءَ فَعَلَيْهَا وَمَا رَبُّكَ بِظَلَّامٍ لِلْعَبِيدِ

**“Kush bën mirë, e bën për dobi të vet, e kush punon keq, punon në dëm të vet. Zoti yt nuk u bën padrejtësi robërve të Tij.”** [Fussilet, 46]

Në një hadith sahih, transmetohet se All-llahu i Lartësuar ka thënë:

يَا عِبَادِي، إِنِّي حَرَّمْتُ الظُّلْمَ عَلَى نَفْسِي، وَجَعَلْتُهُ بَيْنَكُمْ مُحَرَّمًا، فَلَا تَظَالَمُوا

**“O robërit e Mi, Unë ia kam ndaluar padrejtësinë Vetes dhe e kam ndaluar atë midis jush, kështu që mos i bëni padrejtësi njëri - tjetrit!**

يَا عِبَادِي إِنَّكُمْ تُخْطِئُونَ بِاللَّيْلِ وَالنَّهَارِ وَأَنَا أَعْفِرُ الذُّنُوبَ جَمِيعًا وَلَا أُبَالِي  
فَاسْتَغْفِرُونِي أَعْفِرْ لَكُمْ

**O robërit e Mi, ju bëni gjynahe natë e ditë, kurse Unë i shlyej të gjitha gjynahet dhe nuk merakosem. Prandaj kërkon nga Unë falje dhe Unë do t'ju fal!**

يَا عِبَادِي، كُلُّكُمْ ضَالٌّ إِلَّا مَنْ هَدَيْتُهُ، فَاسْتَهِدُونِي أَهْدِكُمْ

**O robërit e Mi, të gjithë ju jeni të humbur përveç atyre që Unë i kam udhëzuar, pra kërkon udhëzimin nga Unë dhe Unë do t'ju udhëzoj!**



يَا عِبَادِي، كُلكُمْ جَائِعٌ إِلَّا مَنْ أَطْعَمْتُهُ، فَاسْتَطْعِمُونِي أُطْعِمْكُمْ.

**O robërit e Mi, të gjithë ju jeni të uritur, përveç atyre që i kam ushqyer Unë, pra kërkoni t'ju ushqej, Unë do t'ju ushqej!**

يَا عِبَادِي، إِنَّكُمْ لَنْ تَبْلُغُوا ضُرِّي فَتَضُرُّونِي، وَلَنْ تَبْلُغُوا نَفِي فَتَنْفَعُونِي

**O robërit e Mi! Ju nuk mund të arrini të Më sillni dëm, që Unë të dëmtohesha nga ju dhe as nuk mund të arrini të Më sillni dobi, që Unë të përfitoja nga ju!**

يَا عِبَادِي؛ لَوْ أَنَّ أَوْلَکُمْ وَآخِرَکُمْ وَإِنْسَکُمْ وَجِنَّکُمْ کَانُوا عَلَيَّ أَتَقَى قَلْبِ رَجُلٍ مِنْکُمْ مَا زَادَ ذَکَ فِي مُلْکِي شَيْئًا يَا عِبَادِي؛ لَوْ أَنَّ أَوْلَکُمْ وَآخِرَکُمْ وَإِنْسَکُمْ وَجِنَّکُمْ کَانُوا عَلَيَّ أَفَجَرَ قَلْبِ رَجُلٍ مِنْکُمْ مَا نَقَصَ ذَکَ مِنْ مُلْکِي شَيْئًا

**O robërit e Mi, sikur të parët tuaj dhe të fundit tuaj, prej njerëzve dhe xhindeve, ta kishin zemrën si të personit më të devotshëm mes jush, kjo nuk do të shtonte gjë në sundimin Tim!**

**O robërit e Mi, sikur të parët tuaj dhe të fundit tuaj, prej njerëzve dhe xhindeve, ta kishin zemrën si të personit më të prishur mes jush, kjo nuk do ta pakësonte aspak sundimin Tim!**

يَا عِبَادِي لَوْ أَنَّ أَوْلَکُمْ وَآخِرَکُمْ وَإِنْسَکُمْ وَجِنَّکُمْ اجْتَمَعُوا فِي صَعِيدٍ وَاجِدٍ فَسَأَلُونِي فَأَعْطَيْتُ كُلَّ إِنْسَانٍ مِنْهُمْ مَسْأَلَتَهُ مَا نَقَصَ ذَکَ فِي مُلْکِي شَيْئًا إِلَّا کَمَا يَنْقُصُ الْبَحْرُ أَنْ يُغْمَسَ فِيهِ الْمَخِيطُ غَمْسَةً وَاحِدَةً

**O robërit e Mi! Sikur të parët tuaj dhe të fundit tuaj, prej njerëzve dhe xhindeve, të mblidheshin në një vend dhe të më luteshin (në një kohë), e Unë t'ia jepja secilit njeri atë që e ka kërkuar, kjo nuk do të pakësonte në sundimin Tim asgjë, përveç aq sa**

## ***mund të pakësohet deti kur zhytet në të gjilpëra një herë!***

يَا عِبَادِي، إِنَّمَا هِيَ أَعْمَالُكُمْ أَحْصِيهَا لَكُمْ، ثُمَّ أَوْفِيكُمْ بِهَا، فَمَنْ وَجَدَ خَيْرًا فَلِيَحْمَدِ اللَّهَ، وَمَنْ وَجَدَ غَيْرَ ذَلِكَ فَلَا يُلُومَنِي إِلَّا نَفْسَهُ.

***O robërit e Mi! Krejt (çështja) është te veprat tuaja, të cilat jua llogaris dhe pastaj jua shpërblej plotësisht ato. Ai që do gjejë mirë, le ta lavdërojë All-llahun, ndërsa ai që do gjejë diçka tjetër, le të mos e fajësojë askënd, përveç vetvetes!"*** [Muslimi etj.]

All-llahu i Lartësuar, edhe duke qenë se s'ka nevojë për krijesat, i krijoi ata dhe u çoi atyre të dërguar, që ua sqaron se çfarë i lumturon e çfarë i mjeron.

Pastaj All-llahu, me vullnetin e Tij, i udhëzoi robërit besimtarë që ta kuptonin të vërtetën, lidhur me çështjet për të cilat të tjerët nuk pajtoheshin. U dhuroi atyre mirësinë e imanit dhe veprave të mira.

Pra, krijimi i tyre është nga mirësia e Tij; dërgimi i profetëve është nga mirësia e Tij; udhëzimi i tyre është nga mirësia e Tij, të gjitha rrugët, qofshin forcat e tyre ose jo, përmes të cilave ata e arrijnë hajrin, janë nga mirësia e Tij.

Kështu edhe sevapi dhe shpërblimi janë nga mirësia e Tij, pavarësisht se atë ia ka detyruar Vetes – ashtu si edhe ia ka ndaluar Vetes padrejtësinë. Këtë gjë Ai e ka premtuar, siç ka thënë:

كَتَبَ رَبُّكُمْ عَلَى نَفْسِهِ الرَّحْمَةَ

**“Zoti juaj ia ka bërë detyrim Vetes mëshirën”** [El-En’âm, 54]

Dhe ka thënë:

وَكَانَ حَقًّا عَلَيْنَا نَصْرُ الْمُؤْمِنِينَ

**“Është detyra Jonë që t’i ndihmojmë besimtarët.”**

[Er-Rûm, 47]

Dhe kjo ndodh në mënyrë të pashmangshme. Është detyrë, për arsye se Ai Vetë e ka bërë detyrë dhe ka premtuar, sepse, përndryshe, krijesat nuk mund ta detyrojnë gjë All-llahun dhe as t’i ndalojnë gjë Atij. Ata janë më të paaftë dhe më inferiorë për diçka të tillë.

Çdo nimet (dhunti) nga Ai është mirësi, ndërsa çdo nikmet (e kundërta e nimetit) nga Ai është drejtësi, siç u përmend në hadithin e kaluar:

إِنَّمَا هِيَ أَعْمَالُكُمْ أَحْصِيهَا لَكُمْ، ثُمَّ أَوْفِيكُمْ إِيَّاهَا، فَمَنْ وَجَدَ خَيْرًا فَلْيَحْمَدِ اللَّهَ،  
وَمَنْ وَجَدَ غَيْرَ ذَلِكَ فَلَا يَلُومَنَّ إِلَّا نَفْسَهُ

**“Krejt (çështja) është te veprat tuaja, të cilat jua llogaris dhe pastaj jua shpërblej plotësisht ato. Ai që do gjejë mirë, le ta lavdërojë All-llahun, ndërsa ai që do gjejë diçka tjetër, le të mos e fajësojë askënd, përveç vetvetes!”**

Dhe në një hadith tjetër sahih [1]:

سَيِّدُ الْإِسْتِغْفَارِ أَنْ يَقُولَ الْعَبْدُ: اللَّهُمَّ أَنْتَ رَبِّي لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ خَلَقْتَنِي وَأَنَا عَبْدُكَ  
وَأَنَا عَلَى عَهْدِكَ وَوَعْدِكَ مَا اسْتَطَعْتُ أَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا صَنَعْتُ أَبُوءُ لَكَ  
بِنِعْمَتِكَ عَلَيَّ وَأَبُوءُ بِذَنْبِي فَاغْفِرْ لِي إِنَّهُ لَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ مَنْ قَالَهَا إِذَا  
أَصْبَحَ مُوقِنًا بِهَا فَمَاتَ مِنْ لَيْلَتِهِ دَخَلَ الْجَنَّةَ

[1] Buhariu, 6306.

*“Lutja eprore për kërkim falje (Sejjid el-istigfâr) është që robi të thotë:*

[All-llahumme, Ente Rabbî, lâ ilâhe il-lâ Ent, khalekTenî we ene ‘abduK, we ene ‘alâ ‘ahdiKe we wa’diKe mesteta’t. E’ûdhu biKe min sher-ri mâ sane’at, ebû’u leKe bini’metiKe ‘alejje, we ebû’u bidhenbî, fegfir lâ, fe innehu lâ jegfirudh-dhunûbe il-lâ Ent]

*“O All-llah! Ti je Zoti im, nuk ka të adhuruar tjetër të drejtë pos Teje. Ti më ke krijuar dhe unë jam robi Yt. Unë i mbahem besëlidhjes dhe premtimit ndaj Teje, aq sa mundem. Tek Ti strehohem të më mbrosh nga sherri i veprave të mia. I pranoj para Teje dhuntitë që mi ke dhënë dhe e pranoj gjynahun tim, andaj më fal, se, vërtet, nuk ka kush tjetër i fal gjynahet, pos Teje!”*

Pjesa ku thotë: *“I pranoj para Teje dhuntitë që mi ke dhënë dhe e pranoj gjynahun tim...”* – është një pranim për dhuntitë e Zotit dhe pranim për gjynahun e robit. Siç ka thënë një dijetar i selefite (i brezave të parë):

*“Unë zgjohem midis dy gjërave: nimetit që All-llahu e zbret për mua dhe gjynahun që ngrihet prej meje tek Ai. Kështu që dua të përgatis për nimetin falënderim dhe për gjynahun istigfar.”*

Prandaj, kush i shpërfill urdhrat dhe ndalesat, premtimet dhe kërcënimet, duke e shikuar Kaderin, ai ka devijuar. Por edhe kush kërkon t’i zbatojë urdhrat

dhe ndalesat duke e shpërfillur Kaderin, ka devijuar.

Kurse besimtari vepron ashtu siç ka thënë All-llahu:

إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ

**“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë.”**

Pra, Atë e adhurojmë, duke e ndjekur urdhrin dhe Atij

i kërkojmë ndihmë, duke e besuar Kaderin. Në një

hadith sahih transmetohet se Profeti (ﷺ) ka thënë:

الْمُؤْمِنُ الْقَوِيُّ خَيْرٌ وَأَحَبُّ إِلَى اللَّهِ مِنَ الْمُؤْمِنِ الضَّعِيفِ وَفِي كُلِّ خَيْرٍ آخِرٌ  
عَلَى مَا يَنْفَعُكَ وَاسْتَعِينُ بِاللَّهِ وَلَا تَعْجِزَنَّ وَإِنْ أَصَابَكَ شَيْءٌ فَلَا تَقُلْ: لَوْ أَنِّي  
فَعَلْتُ لَكَانَ كَذَا وَكَذَا وَلَكِنْ قُلْ: قَدَّرَ اللَّهُ وَمَا شَاءَ فَعَلَ فَإِنَّ لَوْ تَفْتَحُ عَمَلَ  
الشَّيْطَانِ

*“Besimtari i fortë është më i mirë dhe më i dashur tek All-llahu se besimtari i dobët dhe, që të dy kanë mirësi. Përkushtohu çështjeve që të bëjnë dobi, kërkoji ndihmë All-llahut dhe kurrësi mos jini i paaftë (mos përto)! Nëse të godet diçka (e padëshiruar) mos thuaj: “Sikur të bëja kështu, do të ishte kështu ose ashtu!”, por thuaj: “KadderAll-llâhu we mâ shâ'e fe'al” (kështu e ka paracaktuar All-llahu dhe çfarë ka dashur ka vepruar), sepse fjala “sikur” i hap derë shejtanit për të vepruar!” [Muslim, 2664]*

Pra, Profeti (ﷺ) ka urdhëruar dy gjëra:

- t'i përkushtohemi asaj që na bën dobi – e ajo është zbatimi i urdhrave, është ibadeti, është bindja ndaj All-llahut dhe të dërguarit të Tij, dhe
- t'i kërkojmë All-llahut ndihmë – e kjo e përmban

besimin në Kader, pra **Lâ hawle** (nuk ka lëvizje, ndryshim, shndërrim të gjendjes) **we lâ kuwwete** (dhe as fuqi) **il-lâ bil-lâh** (pa e mundësuar All-llahu) dhe se çfarë ka dashur All-llahu (të ekzistojë) bëhet dhe çfarë nuk ka dashur, nuk bëhet.

Ai që mendon se i bindet All-llahut pa mundësimin e Tij, siç pretendojnë **kaderitë mexhusë**[1], ai kështu e mohon:

- plotfuqishmërinë e All-llahut,
- realizueshmërinë e vullnetit të Tij dhe
- faktin që Ai është Krijuesi i çdo gjëje!

---

[1] Autori, siç duket, me shprehjen: “kaderitë mexhusë” ka aluduar në hadithin: *“Kaderitë janë mexhusët e këtij umeti.”* - (Sahih el-Xhâmi’, 4442). Kështu është sepse kaderitë (mohuesit e kaderit) kanë shpikur në Islam një mendim që përputhet me atë të mexhusëve, nga aspekti se mexhusët të gjitha çështjet ekzistuese i lidhin me dy të adhuruar; atë të dritës: Jezdan dhe tjetrin të errësirës: Ehrimen. Ata pretendojnë se Jezdani e krijon të mirën dhe gëzimin, kurse Ehrimeni brengën dhe të këqijat. Këtë e thonë edhe për qeniet edhe për ndodhitë (veprat e qenieve).

E, me këtë besim të kotë përputhet ideologjia e kaderive, të cilët thonë se të mirën e krijon All-llahu, kurse të keqen tjetërkush, përveçse kaderitë e thonë këtë vetëm për veprat e krijesave, jo edhe për krijesat si individë. Pra, sipas tyre, All-llahu i krijon të gjithë personat, kurse veprat e tyre i krijojnë ata vetë! Me këtë dalin në devijim edhe më të rëndë se mexhusët, pasi këta të fundit krijimin e së keqes ia atribuojnë vetëm një qenieje. Për këtë arsye, ashtu si ka pohuar edhe autori në vazhdim, mohimi i kaderit nënkupton:

- se All-llahu nuk është i plotfuqishëm - pasi ekzistuan gjëra që nuk i ka në Dorë;
- se Vullneti i Tij nuk është i realizueshëm - pasi ndodhkan gjëra pa dëshirën e Tij për të ndodhur
- dhe se Ai nuk është Krijuesi i Vetëm - pasi të gjithë njerëzit i krijuakan veprat e tyre të këqija (përkthyesi).

(Nga ana tjetër,) kush mendon se, nëse i jepet sukses ta bëjë atë që do dhe i lehtësohet rruga drejt saj, është i lavdëruar, pavarësisht a pajtohet me urdhrin shariatik apo e kundërshton atë, ai me këtë e refuzon fenë e All-llahut; i përgënjeshton Librat dhe të dërguarit e Tij dhe e përgënjeshton premtimin dhe kërcënimin e Tij. Ky meriton hise nga zemërimi dhe ndëshkimi i All-llahut më shumë se sa meriton i pari. Sepse robi mund të dëshirojë diçka që All-llahu e pëlqen, e do dhe e urdhëron; diçka që e afron tek All-llahu, por dhe anasjelltas, mund të dëshirojë diçka që All-llahu e urren, i zemërohet, e ndalon dhe për të e dënon personin.

Që të dyja këto i janë lehtësuar njeriut t'i bëjë, siç ka thënë Profeti (ﷺ):

كُلُّ مُيسَّرٍ لِمَا خُلِقَ لَهُ أَمَّا مَنْ كَانَ مِنْ أَهْلِ السَّعَادَةِ فَسَييسَّرُ لِعَمَلِ أَهْلِ السَّعَادَةِ وَأَمَّا مَنْ كَانَ مِنْ أَهْلِ الشَّقَاوَةِ فَسَييسَّرُ لِعَمَلِ أَهْلِ الشَّقَاوَةِ

*“...secilit i është lehtësuar rruga drejt asaj për të cilën është krijuar! Atij që është prej njerëzve të lumturisë, do t'i lehtësohet t'i bëjë veprat e njerëzve të lumturisë, kurse atij që është prej njerëzve të mjerimit, do t'i lehtësohet t'i bëjë punët e njerëzve të mjerimit”*

All-llahu i Lartësuar e ka thënë:

مَنْ كَانَ يُرِيدُ الْعَاجِلَةَ عَجَّلْنَا لَهُ فِيهَا مَا نَشَاءُ لِمَنْ نُرِيدُ ثُمَّ جَعَلْنَا لَهُ جَهَنَّمَ يَصْلَاهَا مَذْمُومًا مَذْحُورًا \* وَمَنْ أَرَادَ الْآخِرَةَ وَسَعَى لَهَا سَعْيَهَا وَهُوَ مُؤْمِنٌ فَأُولَئِكَ كَانَ سَعْيُهُمْ مَشْكُورًا \* كُلَّا نُمِدُّ هُوْلَاءِ وَهَؤُلَاءِ مِنْ عَطَاءِ رَبِّكَ وَمَا كَانَ عَطَاءُ رَبِّكَ مَحْظُورًا

“18. Sa për atë që dëshiron të shpejtën (këtë botë kalimtare), **Ne do t’i shpejtojmë (t’i japim) në të çfarë të dëshirojmë, atij që duam. Pastaj ia caktojmë atij Xhehenemin, në të cilin ai do të zhytet, duke qenë i turpëruar dhe i dëbuar.**

19. Sa për atë që dëshiron Ahiretin (botën tjetër) dhe përpiqet për të ashtu si e lyp ai (Ahireti) e duke qenë besimtar, përpjekja e tij do të shpërblehet.

20. Ne i mbështesim të gjithë me dhuratat e Zotit tënd: edhe këta, edhe ata. Dhuratat e Zotit tënd nuk i mohohen (ndalohen) askujt.” [El-Isrâ’, 18-20]

Ka thënë gjithashtu:

فَأَمَّا الْإِنْسَانُ إِذَا مَا ابْتَلَاهُ رَبُّهُ فَأَكْرَمَهُ وَنَعَّمَهُ فَيَقُولُ رَبِّي أَكْرَمَنِ \* وَأَمَّا إِذَا مَا ابْتَلَاهُ فَقَدَرَ عَلَيْهِ رِزْقَهُ فَيَقُولُ رَبِّي أَهَانَنِ

“15. Për sa i përket njeriut, kur Zoti i tij e sprovon atë, duke e ngritur lart (me pasuri) dhe duke i dhënë mirësi, ai thotë: “Zoti im më ka nderuar.”

16. Por, kur e sprovon atë, duke ia ngushtuar riskun (mjetet e jetesës), ai thotë: “Zoti im më ka poshtëruar.” [El-Fexhr, 15-16]

All-llahu e ka shpjeguar se nuk është e vërtetë që, çdonjërin që e ka sprovuar në dynja, e ka poshtëruar.

Ai e sprovon robin edhe me mirëqenie, edhe me vështirësi, ndërsa besimtari duhet të jetë shumë

durimtar dhe falënderues. Atëherë, të dyja këto

sprova i bëhen hajr (mirësi) atij, siç transmetohet në

Sahihun (e Muslimit) se Profeti (ﷺ) ka thënë:



لَا يَقْضِي اللَّهُ لِلْمُؤْمِنِ قَضَاءً إِلَّا كَانَ خَيْرًا لَهُ وَلَيْسَ ذَلِكَ لِأَحَدٍ إِلَّا لِلْمُؤْمِنِ إِنْ أَصَابَتْهُ سَرَاءٌ شَكَرَ فَكَانَ خَيْرًا لَهُ وَإِنْ أَصَابَتْهُ ضَرَاءٌ صَبَرَ فَكَانَ خَيْرًا لَهُ

“Çdo vendim që e cakton All-llahu për besimtarin është vetëm në të mirën e tij dhe kjo nuk vlen për askënd tjetër, përveç besimtarit; (sepse) nëse i vjen mirëqenia, ai falënderon – dhe kjo është në të mirën e tij – e nëse e godet vështirësia, duron – dhe kjo, gjithashtu, është në të mirën e tij.”

Kurse munafiku është i shqetësuar dhe i frikësuar, siç ka thënë i Lartësuari:

إِنَّ الْإِنْسَانَ خُلِقَ هَلُوعًا \* إِذَا مَسَّهُ الشَّرُّ جَزُوعًا \* وَإِذَا مَسَّهُ الْخَيْرُ مَنُوعًا \* إِلَّا الْمُصَلِّينَ \* الَّذِينَ هُمْ عَلَى صَلَاتِهِمْ دَائِمُونَ \* وَالَّذِينَ فِي أَمْوَالِهِمْ حَقٌّ مَّعْلُومٌ \* لِلسَّائِلِ وَالْمَحْرُومِ... - إِلَى قَوْلِهِ - جَنَّاتٍ مُّكْرَمُونَ

19. Vërtet që njeriu është krijuar i shqetësuar:

20. kur atë e godet e keqja, ai trembet fort,

21. por, kur i bie e mira, ai bëhet koprrac.

22. Përjashtim bëjnë ata që falen,

23. e që janë të vazhdueshëm (të rregullt) në faljet e tyre;

24. e që caktojnë një pjesë të pasurisë së tyre

25. për lypësin dhe për nevojtarin” – deri te Fjala:

“Pikërisht ata do të jenë të nderuar në

**kopshtet e Xhenetit.**” [El-Me’ârixh, 19-35]

Pasi njeriut i është lehtësuar (nga njëra anë) të bëjë gjëra të padobishme, madje të dëmshme për të, si gjynahu ndaj All-llahut, përbuzja e nimetit, shkelja e kufijve, dhe (nga ana tjetër) ndonjëherë dëshiron të

bëjë ibadet për All-llahun, t'i bindet Atij dhe të bëjë vepra të mira, por nuk i realizohet kjo, për këto (dy) arsye është urdhëruar që në çdo namaz të thotë:

**“ijjâke ne'abudu we ijjâke neste'in”** (Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty ndihmë të kërkojmë!”)

Në një hadith autentik, Profeti (ﷺ) ka thënë:

يَقُولُ اللَّهُ عَزَّ وَجَلَّ: قَسَمْتُ الصَّلَاةَ بَيْنِي وَبَيْنَ عَبْدِي نِصْفَيْنِ نِصْفُهَا لِي وَنِصْفُهَا لِعَبْدِي وَلِعَبْدِي مَا سَأَلَ فَإِذَا قَالَ: {الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ} قَالَ: حَمَدَنِي عَبْدِي؛ فَإِذَا قَالَ: {الرَّحْمَنُ الرَّحِيمُ} قَالَ: أَتَنَى عَلَيَّ عَبْدِي فَإِذَا قَالَ: {مَالِكِ يَوْمَ الدِّينِ} قَالَ: مَجَدَّنِي عَبْدِي فَإِذَا قَالَ: {إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ} قَالَ: هَذِهِ آيَةُ بَيْنِي وَبَيْنَ عَبْدِي وَلِعَبْدِي مَا سَأَلَ فَإِذَا قَالَ: {اهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ} {صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ} قَالَ: فَهَؤُلَاءِ لِعَبْدِي وَلِعَبْدِي مَا سَأَلَ

*“All-llahu (azze ue xhel-le) thotë: “E kam ndarë namazin (Fatihanë) mes meje dhe robit Tim në dy gjysma, një gjysmë është për Mua, kurse një gjysmë është për robin Tim – dhe robit Tim i takon ajo që e kërkon:*

*Kur robi thotë: “El-hamdu lil-lâhi Rabbil-‘âlemîn” (Të gjitha lavdet i takojnë All-llahut, Zotit të botëve) – All-llahu thotë: “Robi Im më lavdëroi!”*

*Kur thotë: “Er-Rahmânir-Rahîm” (Të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit) – All-llahu thotë:*

**“Robi Im më përlevoi!”**

*Kur thotë: “Mâliki jeumid-Dîn” (Sunduesit të Ditës së Gjykimit) – All-llahu thotë: “Robi Im më madhëroi!”*

*Kur i thotë: “IjjâKe neâbudu ue IjjâKe neste'in” (vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë*

ndihmë) – All-llahu thotë: **“Ky ajet është midis meje dhe robit Tim, dhe robit Tim i takon çfarë ka kërkuar!”**

Kur ai thotë: **“ihdines-sirâtal-mustekîm, sirâtal-ledhîne en’amte ‘alejhim, gajril-megdûbi ‘alejhim we led-dâl-lîn.”** (Na udhëzo në rrugën e drejtë, në rrugën e atyre që Ti u ke dhënë mirësi, e jo në të atyre që u Je zemëruar, as në të atyre që kanë humbur rrugën) – All-llahu thotë: **“Këto janë për robin Tim, dhe robit Tim i takon ajo që e ka kërkuar!”**

Njëri nga dijetarët e selefët (brezave të parë) ka thënë:

“All-llahu (azze ue xhel-le) ka zbritur njëqind e katër Libra. Diturinë e tyre e ka mbledhur te katër Librat: Teurât, Inxhîl, Zebûr dhe Furkân (Kuran). Diturinë e të katrave e ka mbledhur në Kuran, diturinë e Kuranit e ka mbledhur te Mufessali (një e shtata e fundit), diturinë e Mufessalit e ka mbledhur te Fatihaja, ndërsa diturinë e Fatihasë e ka mbledhur te ajeti: **“IjjâKe neâbudu ue IjjâKe neste’în”** (vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë).”

• Çdo vepër, të cilën e bën njeriu, nëse nuk është bindje ndaj All-llahut, adhurim dhe vepër e mirë, atëherë është e kotë.

Sepse dynjaja është e mallkuar dhe çfarë ka në të është e mallkuar, përveç asaj që bëhet për hir të

All-llahut. Edhe nëse fiton me atë vepër ndonjë udhëheqje ose pasuri. Kulmi që mund ta arrijë udhëheqësi është të jetë si Faraoni dhe kulmi që mund ta arrijë pasaniku është të jetë si Karuni!

All-llahu, te surja el-Kasas, ka përmendur nga historia e Faraonit dhe Karunit ndodhi, në të cilat ka mësim për mendarët.

- **Ndërsa çdo vepër, për kryerjen e së cilës All-llahu nuk e ndihmon robin, ajo nuk realizohet dhe nuk jep dobi.**

Pra, ajo çështje që nuk e mundëson All-llahu, nuk realizohet, kurse ajo që nuk bëhet për All-llahun, nuk bën dobi dhe nuk zgjat. Prandaj e ka urdhëruar robin të thotë: “*IjjâKe neâbudu ue IjjâKe neste’în*”.

**Robi, në raport me çështjet e paracaktuara, ka dy gjendje:** gjendja para realizimit të caktimit dhe gjendja pas realizimit të caktimit.

1. Para se të ndodhë ajo që është paracaktuar, e ka për detyrë t’i kërkojë All-llahut ndihmë, t’i mbështetet Atij dhe t’i lutet;

2. nëse ndodh e paracaktuara, pa veprimin e tij, atëherë duhet të durojë lidhur me të ose të jetë i kënaqur me caktimin.

- nëse është me veprimin e tij dhe është ndonjë nimet, duhet ta lavdërojë All-llahun për të;
- kurse nëse është gjynah, i kërkon Atij falje për të.

## Edhe në raport me urdhrin, robi ka dy gjendje:

1. gjendja para veprimit – e ajo është: vendosmëria për ta zbatuar dhe kërkimi i ndihmës nga All-llahu për të;

2. dhe gjendja pas veprimit – e ajo është: kërkimi i faljes për mangësitë dhe falënderimi i All-llahut për mirësinë që ia ka dhuruar.

All-llahu i Lartësuar ka thënë:

فَاصْبِرْ إِنَّ وَعْدَ اللَّهِ حَقٌّ وَاسْتَغْفِرْ لِذَنْبِكَ

**“Andaj, bëhu i durueshëm ti (o Muhamed!), sepse, pa dyshim, premtimi i All-llahut është i vërtetë, dhe lutju Zotit për faljen e gjynaheve të tua...”** [Gâfir, 55]

E ka urdhëruar të durojë për fatkeqësitë e paracaktuara dhe të kërkojë falje për gjynahun. Edhe pse, kuptohet, kërkimi i faljes nuk është i njëjtë te të gjithë, por varet prej personit; veprat e mira të bamirësve mund të llogariten të këqija te njerëzit më të afërm të Zotit.

Gjithashtu ka thënë:

وَإِنْ تَصَبَّرُوا وَتَتَّقُوا فَإِنَّ ذَلِكَ مِنْ عَزْمِ الْأُمُورِ

**“Por, nëse ju duroni dhe ruheni, kjo është vërtet prej çështjeve vendimtare.”** [Âl Imrân, 186]

Jusufi (alejhis-selâm) ka thënë:

إِنَّهُ مَنْ يَتَّقِ وَيَصْبِرْ فَإِنَّ اللَّهَ لَا يُضِيعُ أَجْرَ الْمُحْسِنِينَ

**“Atë që ruhet dhe bëhet i durueshëm, All-llahu e shpërblen, se Ai kurrë nuk ia humb shpërblimin punëmirëve.”** [Jusuf, 90]

Pra, e ka përmendur durimin gjatë fatkeqësive dhe të ruajturit (takvanë) duke i lënë punët e turpshme.

Profeti (ﷺ) ka thënë:

أَحْرِضْ عَلَى مَا يَنْفَعُكَ وَاسْتَعِزْ بِاللَّهِ وَلَا تَعْجِزَنَّ وَإِنْ أَصَابَكَ شَيْءٌ فَلَا تَقُلْ: لَوْ أَنِّي فَعَلْتُ لَكَانَ كَذَا وَكَذَا وَلَكِنْ قُلْ: قَدَّرَ اللَّهُ وَمَا شَاءَ فَعَلَ فَإِنَّ لَوْ تَفْتَحُ عَمَلَ الشَّيْطَانِ

*“Përkushtohu çështjeve që të bëjnë dobi, kërkoi ndihmë All-llahut dhe kurrësi mos ji i paaftë! Nëse të godet diçka (e padëshiruar) mos thuaj: “Sikur të bëja kështu, do të ishte kështu ose ashtu!”, por thuaj: “Kadher All-llahu we mâ shâ’e fe’al” (kështu e ka paracaktuar All-llahu dhe çfarë ka dashur ka vepruar), sepse fjala “sukur” i hap derë shejtanit për të vepruar!” [Muslim, 2664]*

E ka urdhëruar që, nëse i vijnë fatkeqësitë, ta mbajë parasysh Kaderin dhe të mos e vajtojë të kaluarën, po ta dijë se çfarëdo që i ka ndodhur, nuk ka pasur mundësi të mos i ndodhte dhe çfarëdo që nuk i ka ndodhur, nuk ka pasur për t’i ndodhë.

Pra, kur godasin fatkeqësitë, duhet pasur parasysh Kaderin, kurse kur bën gjynahe, duhet kërkuar falje!

All-llahu i Lartësuar ka thënë:

مَا أَصَابَ مِنْ مُصِيبَةٍ فِي الْأَرْضِ وَلَا فِي أَنْفُسِكُمْ إِلَّا فِي كِتَابٍ مِنْ قَبْلِ أَنْ نَبْرَأَهَا إِنَّ ذَلِكَ عَلَى اللَّهِ يَسِيرٌ \* لِكَيْ لَا تَأْسَوْا عَلَى مَا فَاتَكُمْ وَلَا تَفْرَحُوا بِمَا آتَاكُمْ

**“S’ka fatkeqësi që godet tokën dhe ju, që të mos jetë e shënuar në Libër (Leuhi Mahfûdh) më parë se ta krijojmë atë. Kjo për All-llahun është vërtet e**

**lehtë!** (Këtë paracaktim e kemi bërë) që ju të mos dëshpëroheni për atë që ju ka kaluar, por edhe për të mos u gëzuar (me mburrje) për atë që Ai ju ka dhënë.” [El-Hadîd , 22-23]

Dhe ka thënë:

مَا أَصَابَ مِنْ مُصِيبَةٍ إِلَّا بِإِذْنِ اللَّهِ وَمَنْ يُؤْمِنْ بِاللَّهِ يَهْدِ قَلْبَهُ

**“Çdo fatkeqësi që i bie njeriut, ndodh me lejen (caktimin) e All-llahut. Kujtdo që i beson Atij, Ai ia udhëzon zemrën.”** [Et-Tegâbun, 11]

Alkame dhe disa dijetarë të tjerë kanë thënë:

*“(I përshkruari në ajet) është ai njeri që, kur e godet një provë, e di që është prej All-llahut, pajtohet dhe dorëzohet.”*

All-llahu, të Cilin e përlevdojmë dhe lartësojmë, e di më së miri.

---

*Burimi: Mexhmû' el-Fetâwâ, 8/65-77.*

*Përktheu: Blerand Grubi*

*1441H - 2020*

*essunneh.com*